



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL**

Nr. 127 Prot

Tiranë 01.02. 2019

**V E N D I M**

Nr. 6, datë 01/02/2019

***“Mbi përfundimin e procesit të mbikëqyrjes në vazhdim, për verifikimin e zbatimit të vendimit të Komisionerit, nr. 76, datë 03.08.2018.***

Në mbështetje të kompetencës së parashikuar në nenet 11 pika 1, 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar; ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë” dhe Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me Vendimin Nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, në lidhje me verifikimin e zbatimit të vendimit të Komisionerit Nr. 76, datë 03.08.2018, “Mbi verifikimin e zbatimit të ligjshmërisë në procedurën e lirim nga shërbimi civil ndaj nëpunës \*\*\*\*\*”, në institucionin e Inspektoratit Shtetëror të Mjedisit, Pyjeve, Ujërave dhe Turizmit ,

**Vërejtje se:**

Pranë Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, është depozituar kërkesa e regjistruar me nr. 408/11 prot, datë 17.10.2018, në të cilën kërkuësja \*\*\*\*\* , ngre pretendimin se Vendimi nr. 76, datë 03.08.2018, i Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, nuk po zbatohet prej Inspektoratit Shtetëror të Mjedisit, Pyjeve, Ujërave dhe Turizmit në nivel qendror (ISHMPUT), megjithëse kanë kaluar afatet ligjore për kryerjen e veprimeve administrative.

Kjo çështje ka pasur indicie një informacion të dërguar prej nëpunës \*\*\*\*\* , sipas të cilit nga ana e drejtuesve të institucionit ISHPMUT, në nxjerrjen e urdhrit nr. 140, datë 18.04.2018, të Kryeinspektorit, “Për lirim nga detyra” të saj, janë kryer dhe lejuar shkelje në zbatimin e legjislacionit për shërbimin civil, si rrjedhojë e të cilave, është marrë një vendimmarrje e gabuar për vlerësimin negativ në fund të periudhës së provës dhe mos konfirmimin e saj si nëpunëse civile në pozicionin

“Specialiste në Sektorin e Burimeve Njerëzore dhe Komunikimit”, në Drejtorinë Juridike, Prokurimit, Burimeve Njerëzore dhe Komunikimit, në ISHMPU, që ka sjellë si rrjedhojë lirimin e saj nga shërbimi civil.

Në përfundim të hetimit administrativ, për sqarimin e pretendimeve të mësipërme, pas evidentimit të disa shkeljeve në zbatimin e ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, Komisioneri me vendimin nr. 76, datë 03.08.2018, pasi ka konstatuar paligjshmëri në kryerjen e procesit të vlerësimit të nëpunëses në fjalë dhe aktet që e kanë shoqëruar këtë proces, ka kërkuar nga organi publik që ka nxjerrë aktet e kontestuara, Kryeinspektori i Inspektoratit Shtetëror të Mjedisit, Pyjeve, Ujërave dhe Turizmit, të anulojë aktin e vlerësimit në përfundim të periudhës së provës, komunikuar në dt. 10.04.2018 dhe urdhrin nr. 140, datë 18.04.2018, “Për lirim nga detyra”, të nëpunëses \*\*\*\*\*, si një akt i dalë në kundërshtim me përcaktimet e ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, etj. duke lënë një afat 30 ditor për zbatimin e tij.

Vendimi i mësipërm, i është komunikuar rregullisht palëve, por pas kalimit të afatit 30 ditor, nisur dhe nga një ankesë e bërë prej të interesuarës, konstatohet se ky vendim nuk është zbatuar.

Për moszbatimin e këtij vendimi, si ISHMPU-ja ashtu edhe DAP, kanë paraqitur pretendimet e tyre, duke argumentuar ligjërisht, pamundësinë e ekzekutimit të vendimit të Komisionerit, për rastin në fjalë.

Konkretisht, administrata e institucionit ISHPMUT, në mënyrë të përmbledhur, shprehet:

- 1) Me shkresën nr. 4025/1 prot., datë 10.08.2018, “Kthim Përgjigje”, parashtrohet që institucioni ndodhet në fazën e ristrukturimit dhe nuk është e qartë nëse do të ekzistojë i njëjti pozicion pune që ka pasur nëpunësja në strukturën e re dhe se përsëritja e procesit të vlerësimit të saj, siç kërkohet në vendim është i pamundur, për arsye se Zyrtari Raportues i kësaj punonjëse, nuk është më nëpunës i ISHMPUT-së;
- 2) Me shkresën nr. 4025/2 prot., datë 03.10.2018, “Kthim Përgjigje”, informon se Komisioni i Ristrukturimit i ngritur nga DAP, pas verifikimit të dosjes së punonjëses \*\*\*\*\*, duke marrë në konsideratë edhe vendimin e KMSHC-së, ka arritur në përfundimin se zbatimi i vendimit nr. 76, dt. 03.08.2018, është objektivisht i pamundur, për shkak se punonjësja e mësipërme, në kohën që ka qenë e liruar nga detyra dhe ndiqte problemin, rezultoi të ketë aplikuar në procedurën e konkurrimit me kodin #1979, për rekrutimin në pozicionin e punës “Specialist Buxhet/Financë”, në Sektorin e Financës, në Drejtorinë e Shërbimeve Mbështetëse,

në Drejtorinë e Përgjithshme Detare, (me kategori page IV-a), në përfundim të së cilës është shpallur fituese dhe me aktin nr. 6137 prot., datë 23.08.2018, është emëruar nëpunëse civile në periudhë prove, në këtë pozicion.

Përveç sa më sipër, drejtuesit e ISHMPUT pretendojnë se punonjësja \*\*\*\*\* pavarësisht se është njohur me Vendimin nr. 76, datë 03.08.2018, të KMSHC-së, nuk ka pritur zbatimin e tij, por pas përfundimit të procedurës së konkurrimit, ka nënshkruar deklaratën e pranimit të pozicionit të mësipërm, duke marrë për rrjedhojë, aktin e emërimit.

Pra, sipas tyre, punonjësja \*\*\*\*\* me vullnetin e saj të lirë, duke kryer veprime aktive, ka aplikuar dhe është shpallur fituese në një pozicion tjetër vakant, duke mos treguar interes për përgjigjen dhe zbatimin e vendimit të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, veprime të cilat bazuar në nenin 95, të K.P.Administrative, e bëjnë këtë procedurë të braktisur apo të tërhequr prej kësaj punonjëse. Në këto rrethana, bazuar në nenin 181, të “Kodit të Procedurave Administrative në R.SH”, të vlerësohet se objekti i Vendimit nr. 76, datë 03.08.2018, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, është përmbushur.

\*

\* \*

Në të njëjtin përfundim ka arritur dhe Departamenti i Administratës Publike, i cili me shkresën nr. 5915/1 prot., datë 15.10.2018, në përgjigje të shkresës nr. 408/6 prot., dt. 03.08.2018, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, si dhe në vlerësim të argumenteve paraqitur në shkresën nr. 4025/2 prot., datë 03.10.2018, prej ISHMPUT-së, ndër të tjera argumenton :

Gjatë kohës së shqyrtimit të ankesës së nëpunëses \*\*\*\*\* prej KMSHC-së, rezulton se ka ndodhur një fakt i ri që lidhet me marrëdhënien e punës së kësaj punonjëse, pasi kjo e fundit ka aplikuar për pranim në shërbim civil, bazuar në shpalljen me kod nr. 1841, për grupin e katër pozicioneve të punës ndër të cilat edhe pozicioni i punës “*Specialist Buxhet/Financë*”, në Sektorin e Financës, në Drejtorinë e Shërbimeve Mbështetëse, në Drejtorinë e Përgjithshme Detare, ku ajo është legjitimuar për të aplikuar, pasi nuk ka qenë pjesë e shërbimit civil.

Në vijim, pasi janë zhvilluar të gjitha fazat e procedurës së rekrutimit, kandidatja \*\*\*\*\* ka rezultuar fituese duke përzgjedhur pozicionin e sipër përmendur, si dhe duke nënshkruar deklaratën e pranimit të këtij pozicioni, proces i cili ka vijuar me nxjerrjen e aktit të emërimit të nëpunëses në fjalë në pozicionin e zgjedhur. Sipas DAP, nëpunësja \*\*\*\*\* ka nisur një marrëdhënie juridiko-administrative të re, në shërbimin civil.

Ndodhur në këtë situatë, lidhur me objektin e vendimit nr. 76, datë 03.08.2018, të KMSHC sjellë për zbatim, Departamenti i Administratës Publike arsyeton se ndodhet para një akti administrativ objektivisht të pamundur për tu zbatuar, për shkaqet e mëposhtme:

1. Bazuar në nenin 95, të “Kodit të Procedurave Administrative në R.SH”, rezulton se në rastin në fjalë, ndodhemi para një procedure administrative, e cila nuk mund të realizohet prej DAP, në objekt dhe qëllim. Kjo, pasi nëpunësja \*\*\*\*\* ka lidhur një marrëdhënie të re administrative me një institucion tjetër, duke mos treguar interes për marrëdhënien administrative të mëparshme. Si rrjedhojë raporti juridik me ISHMPUT-në nuk ekziston më dhe për pasojë vendimi nr. 76, datë 03.08.2018, i KMSHC, ka humbur qëllimin e tij për zbatim, si dhe nuk mbart më një objekt të mundshëm për t’u zbatuar.

2. Bazuar në nenin 94, pika 2, të “K.P.A në R.SH”, konstatohet se, punonjësja \*\*\*\*\* ka braktisur procedurën e mësipërme me vullnet të plotë, duke mos pasur interes për vazhdimin e procedurës, pasi ka hyrë në një tjetër procedurë administrative, me të njëjtin objekt (*marrëdhënie e re juridike në shërbimin civil*), duke mos pritur zbatimin e vendimit të Komisionerit. Me veprimet e saj aktive, sipas DAP, kjo nëpunëse ka diktuar vendimmarrjen për emërimin e saj në një pozicion të ri, pa pritur ekzekutimin e vendimit të Komisionerit, si dhe duke pranuar emërimin në pozicionin e ri.

3. Bazuar në nenin 181, të “Kodit të Procedurave Administrative në R.SH”, DAP arsyeton se është përpara një akti administrativ (*vendimit nr. 76, datë 03.08.2018, i KMSHC*), objekti i të cilit, është përmbushur në një formë dhe mënyrë tjetër, pasi nëpunësja \*\*\*\*\* me vullnetin e saj, është sistemuar në një pozicion tjetër të nivelit ekzekutiv, në shërbimin civil.

4. DAP konstaton se kjo nëpunëse, meqenëse aktualisht vijon me ushtrimin e detyrave në pozicionin e punës pranë Drejtorisë së Përgjithshme Detare, nuk mund të transferohet në një pozicion tjetër të shërbimit civil edhe për faktin se ligji *ndalon transferimin e një nëpunësi civil në periudhë prove*.

Në përfundim të këtyre argumentimeve ligjore, Departamenti i Administratës Publike kërkon prej Komisionerit rishikimin dhe ndërprerjen e veprimeve të mëtejshme, për zbatimin e vendimit nr. 76, datë 03.08.2018.

\*  
\*       \*  
\*

Sa më sipër, në analizë të gjithë sa u thanë më sipër, mbështetur në përmbajtjen e ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, ligjit nr. 4/2015 “Kodi i Procedurave Administrative në RSH”, akteve nënligjore në fuqi si dhe argumenteve të palëve në këtë hetim administrativ, Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil vlerëson se :

Objekti dhe qëllimi i veprimtarisë së Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil është mbikëqyrja e zbatimit të ligjit për administrimin e shërbimit civil në të gjitha institucionet që punësojnë nëpunës civilë, nëpërmjet kryerjes së mbikëqyrjes dhe inspektimit me kërkesë të institucioneve apo kryesisht, për të krijuar një shërbim civil të qëndrueshëm, profesional, të bazuar në meritë, integritet moral dhe paanësi politike. Në përfundim të kësaj veprimtarie mbikëqyrëse apo inspektimit administrativ të rasteve të ndryshme, Komisioneri ushtron vendimmarrjen e tij, në përputhje me nenin 15, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar.

Thelbi i objektit të veprimtarisë së Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, është kontrolli i rregullshmërisë së veprimeve administrative dhe procedurave të ndjekura gjatë zbatimit të legjislacionit të shërbimit civil, nga ana e njësisë përgjegjëse në organe të ndryshme të administratës shtetërore dhe njësitë e burimeve njerëzore në organet e qeverisjes vendore dhe në ato të pavarura, me qëllim zbatimin e njëjtë e të përpiktë të ligjit dhe mbrojtjen e të drejtave të nëpunësve civilë.

Nëpërmjet kësaj veprimtarie mbikëqyrëse e inspektohen edhe raste të kërkesave të nëpunësve të ndryshëm, të cilët ngrenë pretendime për zbatim jo të drejtë të legjislacionit të shërbimit civil, shkelje të procedurave administrative dhe të të drejtave të nëpunësit civil, apo nxjerrje të akteve administrative në shkelje të dispozitave ligjore. Në raste të tilla, Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, në kuadër të ushtrimit të kompetencave të tij, ndërhyr duke kërkuar marrjen e masave konkrete, për rivendosjen e gjendjes së ligjshmërisë, nga ana e njësisë që menaxhon burimet njerëzore, gjithmonë në këndvështrimin e rritjes së nivelit të menaxhimit të shërbimit civil nga ana e njësisë përgjegjëse, përkatëse dhe jo zgjidhjen e ankesave të nëpunësve, në vetvete. Zgjidhja e një problemi konkret të lindur, apo rivendosja e një të drejte të shkelur, nga një menaxhim jo i mirë nga ana e njësisë së burimeve njerëzore apo i një zbatimi jo korrekt të legjislacionit, rregullohet në kuadër të masave që merren për rregullimin e gjendjes së ligjshmërisë.

Në bazë të pikës 3, të nenit 41, të ligjit nr. 152/2015 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar, nëpunësi civil ka të drejtë të ankohet në gjykatën kompetente për mosmarrëveshjet administrative ndaj çdo veprimi ose mosveprimi, që cenon të drejtat dhe interesat e tij të ligjshme në marrëdhënien e shërbimit civil.

Kjo është arsyeja që kërkesat apo ankesat e ndryshme të paraqitura nga nëpunës të ndryshëm, vlejné për Komisionerin si indicie për të shqyrtuar ligjshmërinë e një akti apo veprimi administrativ të kryer, pa e lidhur këtë verifikim me vullnetin dhe qëndrimin e nëpunësit konkret, ndaj rastit.

Po kështu, Komisioneri nuk e lidh veprimtarinë e tij me faktin se nëpunësi që ka paraqitur një ankesë ose kërkesë, e ka ngritur çështjen para organeve gjyqësore, apo ka hequr dorë nga ankesa ose kërkesa e tij, pasi siç thamë më lart, ai mbikëqyr në mënyrë

të pavarur, ligjshmërinë e veprimtarisë së njësisë të burimeve njerëzore apo drejtuesve administrative dhe akteve të nxjerra prej tyre.

Nëse konstatohet se pretendimet e ngritura në ankesë/kërkesën e paraqitur nuk qëndrojnë apo njësia e burimeve njerëzore ose organi publik që ka nxjerrë aktin, reflektojnë në atë drejtim që është kërkuar ose rekomanduar nga Komisioneri, atëherë qëllimi i vendimit të këtij të fundit, quhet i arritur dhe çështja arkivohet.

Në vijim të arsytimit të mësipërm, në vendimin nr. 76, dt. 03.08.2018 të Komisionerit, janë evidentuar disa momente të një zbatimi jo korrekt të legjislacionit të shërbimit civil, që rregullon procesin e vlerësimit të nëpunësve civilë dhe pasojat që e shoqërojnë këtë proces, duke ja bërë të ditura këto, njësisë përgjegjëse dhe drejtuesve të institucionit të ISHPMUT, në mënyrë që këto parregullsi të mënjanohen dhe të mos përsëriten në të ardhmen, me qëllim përmirësimin në këtë mënyrë të menaxhimit të shërbimit civil dhe mbrojtjen e të drejtave të nëpunësve.

Në këtë këndvështrim, nëpërmjet vendimit janë vënë në dukje mangësitë dhe janë treguar rrugët për rregullimin e gjendjes së ligjshmërisë, duke shërbyer si model për përmirësimin e punës në të ardhmen, ndërsa problemi konkret i nëpunësve \*\*\*\*\* është zgjidhur prej vetë asaj, me kryerjen e veprimeve aktive, të ligjshme, duke konkurruar dhe lidhur një marrëdhënie të re punësimi, në shërbimin civil.

Nisur nga gjithë arsytimi i mësipërm, në zbatim të nenit 16, pika 6, të Rregullores “*Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit*”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2017, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, arrij në konkluzionin se vendimi nr. 76 dt. 03.08.2018, e ka plotësuar qëllimin e tij dhe procesi i mbikëqyrjes në vazhdim për zbatimin e këtij vendimi, duhet të konsiderohet i mbyllur.

### **Për këto arsye:**

Në mbështetje të kompetencave ligjore të përcaktuara në nenin 11 pika 1, 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013 “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, ligjin nr. 44/2015, “*Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë*”, si dhe Rregulloren “*Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit*”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

### **V E N D O S A:**

1. Përfundimin e procesit të mbikëqyrjes në vazhdim, për verifikimin e zbatimit të Vendimit Nr. 76, datë 03.08.2018, “*Mbi verifikimin e zbatimit të ligjshmërisë në procedurën e lirit nga shërbimi civil ndaj nëpunësve \*\*\*\*\**”, në Inspektoratin Shtetëror të Mjedisit, Pyjeve, Ujërave dhe Turizmit.

2. Për këtë vendim të njoftohet institucioni, Inspektorati Shtetëror i Mjedisit, Pyjeve, Ujërave dhe Turizmit, Departamenti i Administratës Publike dhe nëpunësja \*\*\*\*\*.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KOMISIONERI**

**Pranvera Strakosha**